



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2648/7 Prot.

Durrës, më 18.12.2024

V E N D I M

Nr. 63, Datë 18.12.2024

P Ë R

"MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ADMINISTRIMIN DHE PUBLIKIMIN E MATERIALEVE NË RRJETET SOCIALE TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS"

Në mbështetje të ligjit nr.80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar; në ligjin Nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" i ndryshuar; në Rregulloren dhe në Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, si dhe në shkresën e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Studentore me Nr. 2346/2 prot., datë 12.12.2024 "Propozim për miratimin e draft - rregullore mbi administrimin dhe publikimin e materialeve në rrjetet sociale të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës", në mbledhjen e datës 18.12.2024, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullore për administrimin dhe publikimin e materialeve në rrjetet sociale të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët
 - Administratori
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtorët e Drejtorive
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

RREGULLORE

"PËR ADMINISTRIMIN DHE PUBLIKIMIN E MATERIALEVE NË RRJETET SOCIALE TË UNIVERSITETIT ALEKSANDËR MOISIU DURRËS"

Miratur me Vendimin Nr. 63, datë 18 . 12 .2024 të Senatit Akademik

DURRËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

Dispozita të Përgjithshme

**Neni 1
Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për mirëadministrimin e rrjeteve sociale nga njësitë kryesore, njësitë bazë njësitë e tjera dhe nga të gjitha strukturat e brendshme akademike dhe administrative në UAMD lidhur me veprimtarinë e tyre për publikimin e materialeve dhe aktiviteteve të realizuara nga fakultetet, departamentet dhe njësi të tjera të UAMD-së në rrjetet sociale përkatëse të çdo njësie kryesore. Kjo rregullore ka në fokus ndalimin e publikimit në rrjetet sociale të materialeve me karakter sensitiv, diskriminues si dhe çdo formë tjetër jo etike të publikimit, të cilat drejtëpërdrejtë apo tërthorazi që janë në kundërshtim me misionin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës".

**Neni 2
Qëllimi dhe Fusha e Aplikimit**

Kjo rregullore ka për qëllim të sigurojë një administrim efektiv të materialeve që do të publikohen në rrjetet sociale në faqen zyrtare të Universitetit, si dhe materialet që publikohen nga njësitë kryesore, njësitë e tjera dhe të gjitha strukturat përbërëse të UAMD-së. Ajo siguron që publikimet dhe aktivitetet në këto platforma të jenë në përputhje me rregullat dhe standartet e përcaktuara nga Universiteti për menaxhimin e komunikimit institucional dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

**Neni 3
Baza Ligjore**

Kjo rregullore bazohet në Ligjin 80/2015 "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-ve", Ligjin nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" i ndryshuar.

**Neni 5
Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore zbatohet nga të gjitha strukturat akademike dhe administrative të UAMD-së, përfshirë njësitë kryesore, njësitë bazë, njësitë e tjera që kanë në përdorim platformat dixhitale si rrjetet sociale dhe faqet zyrtare të internetit që administrojnë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRE

Neni 6
Organizimi dhe funksionimi

Administrimi i materialeve dhe publikimi i tyre në rrjetet sociale dhe në platformat zyrtare të Njësive Kryesore do të realizohet nga një grup i përbërë nga pesë persona përgjegjës të caktuar nga drejtuesit e njësive kryesore të UAMD-së" të cilët bashkëpunojnë me strukturat akademike dhe administrative në UAMD për të siguruar që materialet të postohen sipas rregullave të caktuara.

Spektori i Komunikimit në UAMD që administron faqen zyrtare të UAMD dhe rrjetet sociale zyrtare të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës shqyrton dhe miraton postimet përpara publikimit, koordinon dhe mbikqyr publikimet e materialeve dhe siguron përputhshmërinë e tyre me standartet etike dhe ligjore si dhe me misionin e UAMD sipas një procesi që përfshin editimin e përmbajtjes, miratimin e saj dhe planifikimin e kohës dhe mënyrën e publikimit në platformat përkatëse.

Neni 7
Administrimi i rrjeteve sociale

1. Administrimi i rrjeteve sociale të Fakulteteve të UAMD-së do të kryhet vetëm nga personat e caktuar nga drejtuesit e njësive kryesore dhe duhet që gjatë gjithë veprimtarisë së tyre të ndjekin përcaktimet e parashikuara në këtë rregullore
2. Në rrjete sociale të cilat administrohen nga njësitë kryesore të UAMD-së duhet të specifikohet në bio faqja zyrtare e UAMD-së www.uamd.edu.al
3. Lejohet publikimi i aktiviteteve që kanë lidhje me procesin mësimor, kërkimin shkencor, veprimtaritë edukative të fakulteteve dhe aktiviteteve të tjera të lidhura.
4. Në rast ndryshimi të personit përgjegjës për administrimin e rrjeteve sociale të fakulteteve duhet që të njoftohet me shkresë/email zyrtar Spektori i Komunikimit për personin zëvendësues.

Neni 8
Kritere dhe Lloje të Postimeve

1. Aktivitetet që mund të postohen përfshijnë ngjarje akademike, ngjarje sociale, aktivitete studentore, projekte kërkimore, njoftime dhe lajme të rëndësishme.
2. Postime nga konferenca, seminare dhe aktivitete të tjera të rëndësishme.
3. Çdo përmbajtje duhet të jetë e rëndësishme për studentët dhe komunitetin akademik dhe duhet të ketë vlerë përfaqësuese për institucionin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

4. Përdorimi korrekt i logos dhe elementeve të identitetit vizual të UAMD-së.

Neni 9

Procedura e Miratimit dhe Publikimit

1. Materialet e propozuara për publikim duhet të dërgohen nga personi përgjegjës për rrjete sociale të secilit fakultet tek Sektori i Komunikimi me email përpara se të postohen.
2. Sektori i Komunikimit do të shqyrtojë përmbajtjen për t'u siguruar që ato janë të përputhshme me këtë rregullore dhe të miratojë postimin.
3. Për aktivitete, evente të planifikuara në kalendarin e aktiviteteve të Fakulteteve, të cilat duhet të publikohen në rrjetet zyrtare të UAMD-së duhet të dërgohen materialet për postim (tekst, foto, video) 3 ditë përpara ngjarjes.
4. Komunikimi me fakultetet do të jetë i vazhdueshëm për të siguruar një koordinim të plotë dhe të suksesshëm të aktiviteteve të UAMD-së në platformat online.

Neni 10

Etika dhe Imazhi i Institucionit

1. Të gjitha postimet duhet të respektojnë etikën profesionale dhe të ruajnë imazhin dhe reputacionin në përputhje dhe misionin e UAMD-së.
2. Postimet duhet të jenë të paanshme, profesionale dhe të respektojnë integritetin e universitetit dhe të përfshijë personelin akademik ndihmës akademik, administrativ dhe studentët.

Neni 11

Siguria dhe Mbrojtja e të Dhënave

1. Përpara publikimit të informacionit dhe materialeve që mund të përmbajë të dhëna personale (si emra, fotografi, etj.), duhet të kërkohet miratimi i personave të prekur (studentë, personeli, pjesëmarrës) ose i autoriteteve kompetente.
2. Postimet që publikohen duhet të jenë në përputhje me ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe të dhënat duhet të mbliidhen, ruhen dhe përpunohen në mënyrë të ligjshme dhe transparente.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS

Neni 12
Kufizime/ndalime

1. Ndalohet publikimi i materialeve të mbrojtura nga “E drejta e autorit” të cilët nuk kanë marrë pëlqimin, bazuar në parashikimet e ligjit nr.35/2016, “për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”, i ndryshuar.
2. Ndalohet publikimi i materialeve me karakter diskriminues.
3. Ndalohet marrja dhe publikimi i materialeve të publikuara nga njësitë kryesore dhe UAMD në rrjetet sociale për efekt të përdorimit personal në rrjetet sociale.
4. Ndalohet përdorimi i rrjeteve sociale dhe i platformave zyrtare të njësive kryesore dhe UAMD për efekte personale nga administratorë të tjerë

Neni 13
Sanksionet administrative

1. Çdo postim që nuk përputhet me këtë rregullore dhe që dëmton imazhin, vlerat dhe reputacionin e UAMD-së ose shkelin etikën e komunikimit dhe dëmtojnë integritetin institucional përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor nga organet përkatëse.

Neni 14
Përshtatshmëria dhe Ndryshimet në Rregullore

1. Kjo rregullore mund të rishikohet dhe modifikohet periodikisht në përputhje me nevojat e reja dhe zhvillimet teknologjike që dalin.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik i UAMD-së. Miratuar me vendimin nr. 63 datë 18.12.2024 të Senatit Akademik të UAMD-së.